# DËSHMI ARKIVI

**A-462500**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Lehtësohen faturat e energjisë për klientët debitorë, ulen kamatëvonesat dhe firmosen 300 aktmarrëveshje në rajonin jugo - Informohu siç duhet |
| ADRESA | `https://radar.al/lehtesohen-faturat-e-energjise-per-klientet-debitore-ulen-kamatevonesat-dhe-firmosen-300-aktmarreveshje-ne-rajonin-jugo/` |
| BURIMI | radar.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:46:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 12:10:03 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b3134c38e57e9c5649ca956475024de512d7c6fdf5b211dbab18b18eb670ce55` |
| TEKSTI | `e76dd9d84ed412a3ddf68dcd2f0f07e8b325307cde366cf3738816851738e3d3` |
| PAMJA | `703d9026042f335609f92070b4739d6006416fcc947d70d6bfcfef52ea55bb9a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4a6d78c61e6ebb80d125e0f15fe9ccc3855a97b52a9baab11468241326b8d243` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4a6d78c61e6ebb80d125e0f15fe9ccc3855a97b52a9baab11468241326b8d243`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EKONOMI

# Lehtësohen faturat e energjisë për klientët debitorë, ulen kamatëvonesat dhe firmosen 300 aktmarrëveshje në rajonin jugo

SEPTEMBER 22, 2026




Gjatë kësaj periudhe FSHU pjesë e OSHEE grup ka nisur aplikimin e skemave lehtësuese për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për abonentët debitorë, duke konfirmuar se deri më tani në rajonin jugor janë lidhur gjithsej 300 aktmarrëveshje, ku përfshihen klientë familjarë dhe jo familjarë.

Ndërsa ata që janë me ndihmë ekonomike kanë përfituar këstin më të ulët prej 1200 lekësh në muaj.

“Numri i debitorëve është ulur si numër. Nuk është më ai numër i debitorëve që ka qenë dikur. Sot flasim që FSHU-ja, pjesë e OSHEE Group, është në një moment shumë të mirë sa i përket pjesës së debitorëve. Pjesa dërrmuese janë familjarë, pasi shtresat që janë në nevojë, për shembull pensionistët ose ata që marrin ndihmë ekonomike, kanë përfituar këstin më të ulët prej 12.000 lekësh të vjetra”, tha Aurel Meçi, Drejtor i njësisë së furnizimit të shërbimit universal në Gjirokastër.

Skema e lehtësuar mbulon detyrimet e krijuara deri më 31 dhjetor 2024 për të gjithë abonentët.

“Të vijnë dhe të përfitojnë, pasi pas datës 31 janar 2026 nuk do të kenë më këto skema. Këto skema janë, në fakt, të veçanta këtë vit, pasi edhe abonentët problematikë me dokumentacionin, siç është emri i subjektit dhe nuk i përket këtij pronari, por një pronari tjetër, ne i procedojmë nëpërmjet një procedure shumë të veçantë, e cila është vetëm për këtë vit”, tha ai.

Këto masa synojnë t'u japin të gjitha kategorive të abonentëve një mundësi reale për të mbyllur përfundimisht faturat e prapambetura dhe për të lehtësuar barrën e tyre financiare.




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.